



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 172, datë 07.11.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“ENERGIA GAS AND POWER” SHPK, NR. 258, SERIA T14, NË VEPRIMTARINË  
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 133, DATË 24.12.2014.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5 pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 07.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 101/5 Prot., datë 31.10.2019 të Drejtorisë së Licensimit Autorizimeve dhe Mbykqyrjes lidhur me “Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power” shpk, me Nr. 258, seria T14, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” shpk, është mbajtëse e licencës me nr.258, Seria T14 në veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014, me afat 5 vjeçar, e cila përfundon në datën 24.12.2019.
- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 461/1 Prot., datë 09.10.2019, ka aplikuar për rinovimin licencës në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuar nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- **Formati i aplikimit** (nenit 9, pika 1, gërma “a”; “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- **Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore**, (nenit 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) janë plotësuar pjesërisht.
- **Dokumentat financiare dhe fiskale**, (nenit 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike**, (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”; “b”; “c” dhe “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të paplotësuar e që lidhet me:

- Neni 9, pika 2: gërmat “a”/”b” (akti i themelimit/statuti) nuk është depozituar një kopje e këtyre dokumentave.
- Neni 9, pika 2: gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), janë depozituar pjesërisht.

*do të njoftohet subjekti që ti paraqesë këto dokumente në ERE, brënda afateve të përcaktuara në nenin 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Energjise Elektrike”.*

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power” shpk, nr. 258, seria T14, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.
2. Drejtoria e Licensimit Autorizimeve dhe Mbyqyrjes së Tregut do të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**